



## MANDATI DHE IMUNITETI I DEPUTETËVE

### MANDATI I DEPUTETËVE

**M**andati paraqet të drejtën e deputetit t'i përfaqësojë qytetarët dhe gjatë ushtrimit të detyrës së deputetit të vendosë sipas bindjes së tij (mandati i lirë).

Deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë zgjedhen për katër vite në zgjedhje të përgjithshme të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë. Deputetët zgjedhen çdo katër vite në 90 ditët e fundit të mandatit të përbërjes së vjetër parlamentare, ose në afat prej 60 ditësh, nga dita e shpërbërjes së Kuvendit.

Mandatin e deputetëve e verifikon Kuvendi dhe ai zgjat nga dita e verifikimit deri në ditën e verifikimit të mandatit të deputetëve të porsazgjedhur, por jo më shumë se 4 vite.

Mandati i deputetëve mund të vazhdohet vetëm gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme.

Kuvendi e verifikon mandatin e deputetëve në mbledhjen konstituive me propozim të Komisionit verifikues të Kuvendit.

Mbledhja konstituive e Kuvendit mbahet më së voni 20 ditë pas zhvillimit të zgjedhjeve. Nëse mbledhja konstituive nuk thirret në afatin e paraparë, atëherë deputetët mblidhen vetë dhe e konstituojnë Kuvendin në ditën e 21 pas mbajtjes së zgjedhjeve.

Me verifikimin e mandatit deputeti merr të drejta dhe detyrime të përcaktuara me Kushtetutë, ligj, Rregulloren e Kuvendit, dispozitat tjera dhe akte të përgjithshme.

Deputeti nuk mund të largohet nga funksioni, mirëpo mund t'i ndërpritet ose merret mandati para mbarimit të kohëzgjatjes së detyrës së deputetit.

Deputetit i ndërpritet mandati para përfundimit të tij: nëse jep dorëheqje; nëse është gjykuar për

vepër penale, për të cilën parashihet dënim me burg me kohëzgjatje prej së paku pesë vite; nëse ndodh rast, që nuk është në pajtueshmëri me detyrën e deputetit; nëse i ndërpritet nënshtetësia e Republikës së Maqedonisë; nëse me vendim të plotfuqishëm privohet nga aftësia për punë ose në rast të vdekjes.

Deputetit mund t'i merret mandati, nëse është i gjykuar për vepër penale ose për vepër tjetër, për të cilën parashihet sanksion, që e bën të jetë të padenjë për kryerje të funksionit të deputetit, si dhe për mungesë të paarsyeshme nga Kuvendi për më shumë se gjashtë muaj.

Propozimin për marrjen e mandatit e dorëzon Komisioni për Rregulloren e Punës së Kuvendit, për Mandat dhe Imunitet, në bazë të informacionit të kryearit të Kuvendit. Nëse deputeti është i gjykuar, informacionin deri të kryetari i Kuvendit e dorëzon gjyqi, i cili e ka shqiptuar dënimin. Propozimi i komisionit shqyrtohet në mbledhjen e parë vijuese të Kuvendit, ashtu që shqyrtimi mund të mbarojë me marrje të vendimit për marrje të mandatit të deputetit. Vendimi merret me shumicë të dy të tretave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

Mandati i deputetëve mund të përfundojë para kohe edhe në rast të vetëshpërbërjes së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Kuvendi shpërbëhet, nëse për një gjë të tillë voton shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

- Deputetët zgjedhen për katër vite.
- Deputetit i ndërpritet mandati ose mund t'i merret mandati vetëm në raste dhe mënyra të përcaktuara me Kushtetutë, ligj dhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

## IMUNITETI I DEPUTETËVE

**D**eputetët në Republikën e Maqedonisë gëzojnë imunitet nga dita e verifikimit të mandatit e deri në përfundim të tij.

Sipas Kushtetutës, deputetët gëzojnë dy lloje të imunitetit: jopërgjegjësini e deputetit (imuniteti material ose qenësor) dhe mosçenimi i deputeti (imuniteti procedural). Së bashku, këta dy lloje të imuniteteve e sigurojnë lirinë e tij/saj në kryerjen e funksionit të deputetit dhe pavarësisë së trupit parlamentar në ushtrimin e pushtetit legjislativ.

Mospërgjegjësia e deputetit nënkupton pamundësinë, që ai të mbahet në përgjegjësi penale ose përgjegjësi tjetër, ose të ndalohet nga organet e rendit për shkak të opinionit të thënë, ose për votim në mbledhjet e Kuvendit ose në organet e tij të punës. Në këtë mënyrë imuniteti material e garanton lirinë e të folurit, por nuk e mbron deputetin nga përgjegjësia për mendimin e shprehur jashtë seancave të



Kuvendit, ose në organet e punës. Për shembull, deputeti nuk do të mbajë përgjegjësi, nëse ofendon ndonjë deputet tjetër ose ndonjë qytetar gjatë debatit parlamentar, por mban përgjegjësi për ofendimin e bërë jashtë Kuvendit.

Ky lloj i imunitetit nuk mund të jetë subjekt i diskutimit për marrje të imuniteti dhe vlen edhe pas mbarimit të mandatit të tij/saj. Imuniteti material nuk e përjashton as detyrën e deputetit, ta respektojë Rregulloren e Punës së Kuvendit. Kryetari i Kuvendit ka të drejtë ta nxjerrë deputetin nga seanca, nëse edhe përkundër vërejtjes ose marrjes së fjalës, deputeti edhe më tej e shkel rendin e seancës ose përdor shprehje, me të cilat shkelet dinjiteti i Kuvendit.

Mosçenimi i deputetit (imuniteti procedural) ka të bëjë me veprat penale, të kryera jashtë

Parlamentit. Ky lloj i imuniteti nuk do të thotë se kundër deputetit nuk mund të iniciohet procedurë për verifikim të përgjegjësisë penale, ose deputeti nuk mund të gjykohej për veprë penale. Imuniteti procedural nënkupton pamundësi, që deputeti të ndalet nga organet e rendit pa miratimin e Kuvendit, përveç nëse është i zënë në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale, për të cilën është paraparë dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vite.

Në rastin e parë, organi kompetent dorëzon kërkesë deri te kryetari i Kuvendit për miratim të paraburgimit të deputetit. Në rastin e dytë, organi kompetent e informon kryetarin e Kuvendit se deputeti është i paraburgosur, për shkak se është zënë gjatë kryerjes së veprës penale, për të cilën është paraparë dënim në kohëzgjatje prej së paku pesë vite. Organi kompetent e informon kryetarin e Kuvendit për paraburgimin e deputetit, madje edhe kur ai nuk është thirrur në imunitetin e tij.

Kryetari i Kuvendit e ka për detyrë, që kërkesën për miratim të paraburgimit, gjegjësisht informacionin se deputeti është paraburgosur, menjëherë t'ia dorëzojë Komisionit për rregullore të punës, për mandat dhe imunitet, i cili e ka për detyrë ta shqyrtojë kërkesën, gjegjësisht informimin dhe në afat prej dy ditësh të dorëzojë raport deri te kryetari i Kuvendit. Për mbledhjen e Komisionit informohet deputeti, të cilit i dedikohet kërkesa. Në bazë të raportit të Komisionit, Kuvendi më së voni në afat prej tre ditësh vendos nëse do të jep pëlqim për paraburgim të deputetit.

Nëse Kuvendi nuk e miraton paraburgimin, atëherë deputeti do të lirohet menjëherë, madje edhe nëse deputeti nuk është thirrur në imunitetin e tij.

- Deputetët në Republikën e Maqedonisë gëzojnë dy lloje të imuniteteve: mospërgjegjësia e deputetit (imuniteti material ose qenësor) dhe mosçenimi i deputetit (imuniteti procedural)
- Imuniteti material e garanton lirinë e të folurit në seanca të Kuvendit ose në organet e tij të punës
- Imuniteti procedural ka të bëjë me pamundësinë për paraburgim për vepra penale të kryera jashtë Kuvendit
- Imuniteti material vlen edhe pas ndërprerjes së mandatit të deputetit, ndërsa imuniteti procedural vlen vetëm derisa zgjat mandati i deputetit